

## NJOFTIM PËR PJESËMARRJE

Autoriteti : **Bordi i Çështjeve të Mira të Lotarisë Kombëtare**

Bordi i Çështjeve të Mira të Lotarisë Kombëtare, fton për të paraqitur kërkesat për pjesëmarrje në procesin e përzgjedhjes së projekteve, organizatave apo eventeve fitues që do të përfitojnë financim nga ky Bord.

Kanë të drejtë të aplikojnë, të konkurrojnë dhe të paraqesin projektpropozimet e tyre të gjithë aplikuesit që mund të jenë insitucione publike, buxhetore apo jobuxhetore, persona fizikë apo juridikë jobuxhetorë, që janë regjistruar sipas ligjit dhe kryejnë veprimtari në përputhje me qëllimin e përcaktuar në statutin e tyre.

Nuk mund të konkurrojnë partitë politike, sindikatat, institucionet fetare dhe organizatat politike.

Bordi ofron:

- Fonde për periudha afatshkurtra deri në 1 (një) vit fiskal; me vlerë deri në 1 000 000 Lekë (një milion).
- Fonde për periudha afatgjata deri në 3 (tre) vite fiskale me vlerë deri në 3 000 000 Lekë (tre milion). Fondet afatgjata u jepen aplikuesve për projektpropozime, zbatimi i të cilave parashikon një kohëzgjatje deri në 3 (tre) vite fiskale<sup>1</sup>.

### Përshkrim i Përgjithshëm i Procesit të Përzgjedhjes

Kjo procedurë përfshin dy faza kryesore:

#### Faza 1 – Paraqitja e Projektpropozimeve

Aplikuesit do të dorëzojnë projektpropozimet e tyre, së bashku me listën e dokumenteve për aplikim, pranë Autoritetit të mësipërm. Ky Autoritet, do të shqyrtojë projektpropozimet dhe dokumentacionin shoqërues për t'u siguruar që ato plotësojnë kërkesat e nevojshme. Kandidatët, që nuk i plotësojnë këto kërkesa, skualifikohen dhe njoftohen për skualifikim.

Kërkesat për Aplikuesit:

- Kanë të drejtë të aplikojnë, të konkurrojnë dhe të paraqesin projektpropozimet e tyre të gjithë aplikuesit që mund të jenë insitucione publike, buxhetore apo jobuxhetore, persona fizike apo juridikë jobuxhetorë, që janë regjistruar sipas ligjit dhe kryejnë veprimtari në përputhje me qëllimin e përcaktuar në statutin e tyre.

---

<sup>1</sup> Viti fiskal për projektet afatgjata që parashikohen me një kohëzgjatje deri në 3 (tre) vjet, mban në konsideratë që tërësia e projektit të fillojë dhe të mbarojë (dorëzohet) gjatë periudhës Janar 2021 – Mars 2023.

- Nuk mund të konkurrojnë partitë Politike, sindikatat, institucionet fetare dhe organizatat politike.
- Aplikuesit, personat fizikë ose juridikë jobuxhetorë duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtme:
  - a. Formulari i plotësuar i aplikimit, i vulosur dhe i nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i Organizatës (Formulari duhet firmosur në çdo faqe);
  - b. Vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor për regjistrimin e aplikuesit ose ekstraktin e regjistrimit në QKR;
  - c. Një dokument që vërteton se aplikuesi nuk është në ndjekje penale dhe nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë;
  - d. Një dokument që vërteton se aplikanti nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi;
  - e. Kopje të pasqyrave financiare për tri vitet e fundit, të audituara dhe të depozituara në organet tatimore, shoqëruar me një vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore.
  - f. Një dokument që vërteton se aplikuesi ka paguar rregullisht sigurimet shoqërore për stafin e punësuar, vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore.
  - g. Një dokument që vërteton se aplikuesi nuk ka detyrime tatimore, të lëshuar nga organet tatimore. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore.
  - h. Licencën/lejen për ushtrim veprimtarie, vetëm në rastet kur aktiviteti/ veprimtaritë e kërkuara për t'u financuar nuk mund të kryhen sipas ligjit, pa zotëruar një licencë të dhënë nga autoritetet publike;
  - i. Dokumentacionin e nevojshëm (relacione, referenca):
    - a. Referenca nga persona fizikë ose juridikë me të cilët ka patur bashkëpunim në realizimin e projekteve (të ndryshme, të mëparshme) sipas fushës se veprimtarisë në të kaluarën;
    - b. Ose Relacion të përgatitur nga vetë aplikuesi, nëse nuk ka patur ndonjë bashkëpunim (projekt) tjetër të realizuar në të kaluarën
- Dokumentacionet e paraqitura nga Institucionet Publike, buxhetore apo jo-buxhetore, që duhet të paraqesin për shqyrtim pranë Bordit, projektpropozimin, dokumentat e mëposhtme si dhe çdo dokument shtesë që mund të kërkojë Bordi:
  - a. Formulari i plotësuar i aplikimit, i vulosur dhe i nënshkruar nga përfaqësuesi i Institucionit;
  - b. Akti ligjor ose nën-ligjor i krijimit.
  - c. Autorizim nga titullari i Institucionit për përfaqësim në procesin e aplikimit.
  - d. Vërtetim që projekti i propozuar nuk është financuar nga programet buxhetore ose nuk është në planin e buxhetit afatmesëm.

Çdo dokument nga dokumentacionet e parashikuar më sipër, duhet të jetë në origjinal ose kopje e noterizuar dhe të jetë lëshuar brenda 3 (tre) muajve nga data e aplikimit.

Në çdo rast, Bordi mund të kërkojë dokumentacion shtesë, të nevojshëm për vlerësimin e projektpropozimit. Aplikuesit, të cilët kanë projekt në proces të mbështetur nga Bordi, nuk kanë të drejtë të aplikojnë përpara përfundimit dhe paraqitjes së raportit final të këtij projekti.

**Kërkesa për Aplikim duhet të paraqitet pranë deri më datën 24 Maj 2021, në adresën:  
Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
“Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, Nr.3  
Tiranë, Shqipëri**

Aplikantët duhet të dorëzojnë vetëm projektpropozimin origjinal. Propozimi duhet të futet në një zarf jotransparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e Aplikuesit dhe të ketë të shënuar:

“Propozim për Bordin e Çështjeve të Mira.

**“MOS E HAPNI, ME PËRJASHTIM TË RASTEVE KUR ËSHTË I PRANISHËN KOMISIONI I BORDIT TË ÇËSHTJEVE TË MIRA”.**

## **Faza 2 – Shqyrtimi i propozime dhe marrja e vendimit**

Pas marrjes së projektpropozimeve, Autoriteti i shqyrton dhe përzgjedh propozimin/et më të mirë të vlerësuar.

Vlerësimi mbështetet në përputhjen e projektpropozimit të paraqitur nga aplikuesi në procedurat e konkurrimit me qëllimin e organizatës/aplikuesit dhe programin që zbaton, kapacitetet e aplikuesit, efektshmërinë e aktiviteteve, pritshmërinë dhe koston e tyre.

Subjekti/et përfitues nënshkruan një kontratë me kryetarin e Bordit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga data e përfundimit të vlerësimit të rezultateve të konkurrimit. Në kontratë përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe specifike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në sasinë e fondit të marrë, dhe aktivitetet për t’u ndërmarrë. Projektet e shpallura fituese, organizatat apo eventet, si edhe vlera e miratuar për projektet dhe mënyra e shpërndarjes së kësaj vlere do të bëhen publike në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave si edhe në faqen zyrtare të Lotarisë Kombëtare.